



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përfitimi i kontrollit nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 98,83% të Banka e Tiranës Sha nga Piraeus Bank SA tek Balfin Shpk dhe Komercijalna Banka AD Skopje.

Përfaqësuesi ligjor i palës njoftuese me shkresën Nr.484 Prot., datë 29.08.2018 “Njoftim përqendrimi në lidhje me shitblerjen e 98.83% të kuotave të Tirana Bank, nga Piraeus Bank S.A te Balfin Shpk dhe Komercijalna Banka AD Skopje” ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dokumentacionin përkatës nëpërmjet të cilit Balfin Shpk ka përfutuar kontrollin nëpërmjet blerjes së aksioneve të Banka e Tiranës Sha.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi 1: Balfin Shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pjesë e Balfin Group, është një nga sipërmarrjet më të mëdha private investuese në fushën e biznesit në Shqipëri dhe rajon. Objekt i aktivitetit të kësaj shoqërie është investimi me pjesëmarrje në kuota, ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave, informatikës etj.

Blerësi 2: Komercijalna Banka AD Shkup¹ është themeluar në 1955² dhe ditët e sotme kjo bankë është një bankë universale që kryen një gamë të gjerë aktivitetesh bankare, si depozita, aprovime të kredive për shoqëri dhe individë, shërbime lidhur me pagesa kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

Shitësi: Piraeus Bank Societe Anonyme, është shoqëri aksionare, pjesë e Piraeus Bank Grup, i cili ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare tek një numër i madh klientësh në Greqi. Objekti i aktivitetit janë të gjitha aktivitetet bankare të ligjshme ose të vlefshme ligjrisht, përfshirë pranimin e depozitave ose fondeve të tjera të kthyeshme, dhënieve të kredive ose financimeve të tjera; qiranë financiare; pagesat përfshirë edhe shërbimet e transfertave monetare; lëshimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesave etj.

Shqipëri: Filiali i kësaj shoqërie në Shqipëri është Banka e Tiranës SHA.

Shoqëria target: Tirana Bank SH.A është një institucion financiar bankar i nivelit të dytë.

Objekti i aktivitetit të kësaj banke përfshijnë veprimtaritë bankare lidhur me pranimin e depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ri pagueshme nga publiku që do të përdoren

¹ Kjo bankë numëron rreth 4896 aksionarë të përbërë nga individë dhe entitetet ligjore të juaj dhe lokalë. Zotëruesi mazhoritar i aksioneve me 10.09% është shoqëria ADORA Engineering DOOEL, e cila operon në fushën e ndërtimeve të ndërtesave rezidenciale dhe jo-rezidenciale (ku aksionar mazhoritar është Z.Vanco Cifliganec).

² Burimi: Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë

për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet; emetimin e mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike; qira financiare, të gjitha pagesat dhe shërbimet e transferimit të parave, garanci dhe letër krediti, faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare etj.

Balfin Shpk dhe Komercijalna Banka synon të blejë 98.83% % të aksioneve me të drejtë vote të Banka e Tiranës Sh.a. Përqendrimi i propozuar ka të bëjë me përfitimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së aksioneve të Banka e Tiranës Sha.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.